

Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës Komora inženjera Republike Kosovo Chamber of Engineers of the Republic of Kosovo	
Niveli org. Org. Jedinica Org. Unit	Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No.
Nr. ifaqoja Dr. Stranica Nr. Pages	Data: Datum: Date:
PRISHTINË / A No.1	



ODA E INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Nr. 43-BD/2025
Prishtinë: 28.10.2025

Bordi Drejtues i ODËS SË INXHINIERËVE NË FUSHËN E NDËRTIMIT me nr. Fiskal 603383324, në mbështetje të nenit 17, paragrafi 5, nënparagrafi 5.13 dhe 5.14 të LIGJIT NR. 08/L – 012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit, në mbështetje të nenit 8, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, 1.5 dhe 1.7, paragrafi 2, nënparagrafi 2.1, 2.3, 2.5, 2.7 dhe 2.11, neni 24, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3, 1.5, 1.11, 1.16 dhe 1.19 të STATUTIT TË ODËS SË INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR PERIUDHËN E PËRKOHSHME, i miratuar më datën 31.12.2024, me nr. Të protokollit 8648/24, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datën 28.10.2025, nxjerr këtë:

VENDIM

1. Për themelimin e këshillave profesional / grupeve të ekspertëve në kategori sim ë poshtë.
2. Kategoritë:
 - 2.1 - Përgatitjen e programit për edukimin e vazhdueshëm të anëtarëve të licencuar të Odës.
 - 2.2 - Hartimin e propozimeve për amendementim të LIGJI NR. 08/L - 012 , UA MMPHI NR.06 2023, Statutit, Kodit Etik dhe Rregulloreve si dhe Hartimin e Rregulloreve të Reja të OIRK-së.
 - 2.3 - Hartimin e propozimeve për amendementim të Ligjit të Ndërtimit dhe Ligjit të Planifikimit Hapësinor.
 - 2.4 – Për përmbajtjen e dokumentacionit teknik të projektimit sipas udhëzimeve administrative (doracak).
3. Anëtar i këshillave profesional dhe grupeve të ekspertëve të jenë vetëm anëtarët e OIRK-së të cilët duhet të rekrutohen nga Bordi Drejtues përmes **FTESËS PËR SHPREHJE INTERESI**.
4. Kompenzimi i anëtarëve të këshillave profesional dhe grupeve të ekspertëve të realizohen nga Linja Buxhetore e Shpenzimeve për Odën e Inxhinierëve për vitin 2025; Kategoria: Paga dhe Mëditje, Pos Nr.: 7 , Emërtimi i pozicionit: Grupe Punuese, Këshilla Profesional dhe grupe të ekspertëve, etj, si dhe në pajtim me rregulloren për shumat e kompensimit për anëtarët e organeve të Odës së inxhinierëve të Republikës së Kosovës.
5. Mënyra e punës së këshillave profesional / grupeve të ekspertëve përcaktohet në mënyrë më të detajuar me Aktin e brendshëm të punës së tyre të miratuar nga Bordi Drejtues.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit




Vendimi i dërgohet:

- Komisionit Mbikqyrës.
- Bordit Drejtues të OIRK-së
- Arkivit të OIRK-së.



**ODA E INXHINIERËVE
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

Bordi Drejtues i OIRK-së:

1. **Arsim Rapuca**
Kryetar i OIRK-së 
2. **Mimoza Shahini**
Anëtare e Bordit Drejtues të OIRK-së 
3. **Kadri Morina**
Anëtarë i Bordit Drejtues të OIRK-së 
4. **Afrim Demiri**
Anëtarë i Bordit Drejtues të OIRK-së 
5. **Nebi Pllana**
Anëtarë i Bordit Drejtues të OIRK-së 
6. **Bujar Jupaj**
Anëtare e Bordit Drejtues të OIRK-së 
7. **Sami Kolgeci**
Anëtarë i Bordit Drejtues të OIRK-së 